



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1707/4 prot

Datë 21.09.2021

**V E N D I M**

**Nr.657/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2021 me

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Health&Light” SHPK dhe “Montal” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04463-09-02-2021 me objekt Loti 1 “Ekokardiography”, me fond limit 39,700,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar më datë 05-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
Tiranë  
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

**Ankimues:**

“Health&Light” SHPK  
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd.11, Shk.4,  
Ap.4 Tiranë

“Montal” SHPK

Rruga Dervish Hima-3 Kullat, K.3, A9/2 Tiranë

**Baza Ligjore:**

Nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04463-09-02-2021 me objekt Loti 1 “Ekokardiography”, me fond limit 39,700,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 05-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

II.2. Në datën 10.09.2021 operatori ekonomik “Health&Light” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Ndërsa në datën 13.09.2021 operatorin ekonomik Montal SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit ( objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesve.

II.5. Në datën 17.09.2021 dhe 21.09.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar nëpërmjet postës elektronike si dhe pranë protokollit të KPP-së informacionin lidhur me trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues “Health &Light” SHPK dhe “Montal“ SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesat e operatorëve ekonomikë ankimues “Health &Light” SHPK, “Montal“ SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesve.

Konkretisht me shkresat nr.2326/2 prot datë 17.09.2021 me lëndë kthim përgjigje formularit të ankesës nr.2326 prot datë 10.09.2021 drejtuar shoqërisë “Health&Light“ SHPK, dhe nr.2338/1 prot datë 21.09.2021 me lëndë kthim përgjigje formularit të ankesës nr.2338 prot datë 13.09.2021 drejtuar shoqërisë, “Montal“ SHPK autoriteti kontraktor (KSHA) ka pranuar pretendimet e ankimuesve si më poshtë:

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK : në pajisjen I Eko Kardio Vaskulare përcaktimi i kufijve (rangu) të frekuencave nga 1.5 deri në të paktën 4 MHz favorizon një model të caktuar të një prodhuesi të vetëm që është General Electric i cili ofron zgjidhjen e tij për një sondë me frekuencë 1-4 MHz. Pse të mos kërkohej rangi i **frekuencave 1-5 MHz** i cili përvecse rrit përfitueshmërinë klinike hap dhe konkurrencën pa cënuar asnjë OE. **Ose dhe rangi 2-4 MHz** që përdoret gjërësisht në aplikime kardiake.*  
*Argumentimi i AK: Frekuenca e sondës kardiake të kërkuar 1.5 MHz nuk kufizon prodhuesin Philips i cili mund të ofrojë sondën e mëposhtme që e plotëson specifikimin e kërkuar. Modeli X5 (Frekuenca 1-5 MHz).*  
*Bëhet: AK sqaron se pranon të bëjë një modifikim të këtij specifikimi teknik për të qenë sa më të qartë dhe më të kuptueshëm për OE në mënyrë që të mos vlerësohet si*

**kriter përjashtues: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë: të përfshijë diapazonin 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK në Pajisjen 3 Eko kardio vaskulare (transtorakale me 3 sonda), kërkesa që frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë të jetë nga 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz favorizojnë të njëjtin prodhues duke çenuar konkurrencën. Për të qenë më gjithpërfshirës AK duhet të kërkojë 2-4 MHz dhe fushë pamje 55 ose për të ruajtur kërkesat klinike dhe trajtim të barabartë të gjithë OE të kërkojë 1-5 MHz .

**Argumentimi i AK Bëhet:AK sqaron se pranon të bëjë një modifikim të këtij specifikimi teknik për të qenë sa më të qartë dhe më të kuptueshëm për OE në mënyrë që të mos vlerësohet kriter përjashtues.**

**Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë: të përfshijë diapazonin 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz.**

**Fushpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 55 ose më shumë.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK për Pajisjen 4 Eko Radiologjike me sondë abdominale konvekse dhe lineare është kërkuar ndër të tjera....

Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit. Kjo kërkesë çënon në mënyrë flagrante konkurrencën pasi asnjë nga prodhuesit e ekove në botë nuk do të mund të ofrojë një produkt në këtë nivel. Ju lutem ta modifikoni.

**Argumentimi i AK: Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka kërkuar se si duhet ndryshuar specifikimi i mësipërm. Për këtë arsye është ulur intervali dinamik me 50 dB dhe është shtuar fjala për afërsisht për të përfshirë vlera të për afërta që mund të kenë prodhues të ndryshëm.**

**Bëhet: Interval dinamik i rregullueshëm për afërsisht 350 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në 3 KHz në varësi të modalitetit të skanimit. Edhe kjo kërkesë favorizon po të njëjtin prodhues dhe çënon konkurrencën. Kërkojmë që kjo kërkesë të modifikohet ose të hiqet pasi nuk ka asnjë relevancë klinike.

**Argumentimi i AK. Për të siguruar një pjesmarrje sa më të madhe AK vendosi të bëjë ndryshimin e këtij specifikimi teknik duke pranuar pretendimet e OE-së.**

**Bëhet:Frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në të paktën 2 KHz në varësi të modalitetit të skanimit.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Sondë konvekse e përdorshme ndër të tjera për ekzaminimet shear ëave; Frekuenca e aplikueshme në

varësi të thellësisë 1 MHz deri në të paktën 5MHz; Fushëpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 100 gradë ose më shumë.

Në kërkesën më sipër kërkohet që të përdoret për ekzaminimet Shear –ëave ndërkohë që nuk specifikohet për çfarë ekzaminimesh dhe është e paqartë çfarë aplikacionesh apo modalitete skanimit operatorët duhet të ofrojnë. Ju lutem ta qartësoni.

**Argumentimi i AK. Përshkrimi i sondës konvekse sipas specifikimit më lart përmban një lapsus në lidhje me funksionin shear-ëave i cili do të hiqet nga përshkrimi.**

**Bëhet: Sondë konvekse: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 1 MHz deri në të paktën 5MHz; Fushëpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 100 gradë ose më shumë.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Sondë lineare. Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 2 MHz deri në të paktën 10 MHz ose 4 MHz deri në të paktën 12 MHz. Fusha minimale e skanimit 35 mm. Sqarojmë se kërkesa e sondës më sipër bie ndesh me kërkesën tjetër ku citohet: Modalitet Elastografi strain. E aplikueshme me sondë lineare. Dihet që me modalitetin elastografisë Strain kërkon minimalisht një fushë minimale skanimit prej 50 mm. Kërkojmë që ky specifikim të modifikohet si dhe rangun e frekuencave nga 4-12 MHz të bëhet 5-12 MHz për të qenë më gjithpërfshirëse sic kërkon LPP.

**Argumentimi i AK: Elastografia strain përdoret për ekzaminimin e indeve të buta dhe nuk ka ndonjë kufizim në lidhje me fushën minimale të skanimit. Fusha e skanimit prej 50mm që ju propozoni është përfshirëse dhe ezauruese ndaj specifikimit të kërkuar i cili nuk ka nevojë të ndryshohet. Në lidhje me rangun e frekuencave do të kryhen ndryshimet përkatëse sipas propozimit tuaj.**

**Bëhet: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë të përfshijë diapazonin 2 MHz deri në të paktën 10 MHz ose të përfshijë diapazonin 5 MHz deri në të paktën 12 MHz.**

**Fusha minimale e skanimit 35 mm.**

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Për pajisjen 5 Eko Radiologjike e avancuar është kërkuar ndër të tjera:  
Këndi i skanimit maksimal duhet të arrijë deri në të paktën 160 gradë në varësi të sondës së përdorur.  
Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.  
Frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në 3 KHz në varësi të modalitetit të skanimit.

- Kërkesa që këndi i skanimit maksimal duhet të arrijë deri në të paktën 160 gradë në varësi të sondës së përdorur është jo e qartë pasi asnjë nga sondat e kërkuara për këtë specifikim nuk është kërkuar me atë kënd skanimit ndaj AK duhet të sqarohet arsyen e vendosjes së kësaj kërkesë.

*Argumenti i AK: Ju sqarojmë se këndi i skanimit maksimal nuk i referohet sondave por aftësisë së pajisjes për të arritur një fushpamje të caktuar.*

- *Kërkesa teknike Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit çënon në mënyrë flagrante konkurrencën pasi asnjë nga prodhuesit e Ekove në botë nuk do mundet të ofrojë një produkt me këtë nivel ndaj kjo kërkesë duhet të modifikohet.*

*Argumentimi i AK: Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka kërkuar se si duhet ndryshuar specifikimi i mësipërm. Për këtë arsye është ulur intervali dinamik me 50 dB dhe është shtuar fjala “përafërsisht” për të përfshirë vlera të përafërta që mund të kenë prodhues të ndryshëm.*

*Bëhet: Interval dinamik i rregullueshëm përafërisht 350 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.*

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK : Sondë lineare (aplikime vaskulare dhe muskuloskeletale)*

*Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 2 MHz deri në të paktën 10 MHz*

*Fusha minimale e skanimit 50 mm.*

*Për këtë sondë na duket rangi i kërkuar 2-10MHz përsëri qëllimisht pasi për aplikime vaskulare dhe muskuloskeletale frekuencat e përdorshme janë nga 5-12 MHz.*

*Argumentimi i AK. Në vijim të propozimit konkret nga operatori ekonomik do të përshatën frekuencat në rangun 5-12 MHz ose më gjërë.*

*Bëhet: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 5-12 MHz osë më gjërë.*

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes Montal SHPK: **Artikulli Nr.4 Eko Radiologjike me sondë abdominale konvekse dhe Lineare***

*Kerkohet: Sonde Konvekse e perdorshme nder te tjera edhe per ekzaminimet “shear-ëave”; Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz; Ne specifikimin e mesiperme eshte kerkuar qe sonda konvekse te jete e perdorshme per ekzaminime “shear-ëave” nderkohe qe ky funksion nuk kerkohet ne specifikimet teknike per kete pajisje. Gjithashtu, nuk eshte kerkuar as qe funksioni “shear-ëave” te jete opsional per permiresime ne te ardhmen. Per kete arsye, mendojme se kerkesa qe sonda konvekse te jete e perdorshme per aplikime “shear-ëave” nuk perputhet me kerkesat e aplikimit te kesaj pajisjeje. Ju lutemi te keni ne konsiderate faktin qe nje sonde konvekse me funksion “Shear-ëave” nuk funksionon ne nje pajisje ekografike e cila nuk e disponon kete teknologji. Prandaj, kerkojme qe kjo kerkese te hiqet.*

*Sa me siper, per te mundesuar pjesemarrjen e kompanise tone dhe produkteve prestigjose qe mund te ofrojme, kerkojme qe specifikimi teknik final te ndryshohet si vijon:*

***Sonde Konvekse Abdominale***

*Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz.*

**Argumentimi i AK:** *Përshkrimi i sondës konvekse sipas specifikimit më lart përmban një lapsus në lidhje funksionin shear-ëave i cili do të hiqet nga përshkrimi.*

*Sonde Konvekse Abdominale*

*Gjithashtu, per te garantuar nje pjesëmarrje sa me te gjere ne kete procedure prokurimi Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: te perfshije diapazonin 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz.*

**Bëhet**

*Sonde Konvekse Abdominale*

*Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: te perfshije diapazonin 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz*

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Montal SHPK: *Sonde Lineare Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 4MHz deri ne te pakten 12 MHz. Ne lidhje me specifikimin e mesiperem, kerkojme qe ne diapazonin e frekuencave te perfshihet edhe frekuenca 5-11 MHz per te mundesuar ofrimin e produkteve prestigjioze te prodhuesit GE Healthcare qe kompania jone perfaqeson dhe per te qene ne perputhje me Nenin 36, Pika 2 -Specifikimet teknike te ligjit te prokurimit publik. Sa me siper, kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si vijon:*

*Sonde Lineare*

*Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 5MHz deri ne te pakten 11 MHz.*

**Vlerësimi i KSHA.**

**Bëhet:** *Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: : te perfshije diapazonin 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 5MHz deri ne te pakten 11 MHz.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

**Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankimues “Health&Light SHPK, “Montal” SHPK, për modifikimin e specifikimeve teknike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 17.09.2021 autoriteti kontraktor ka dërguar nëpërmjet postës elektronike si dhe pranë protokollit të KPP-së informacionin lidhur me trajtimin e ankesave të operatorëve

ekonomikë ankimues “Health &Light” SHPK, dhe “Montal“ SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesat e operatorëve ekonomikë ankimues “Health &Light” SHPK, “Montal“ SHPK dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesve.

III.1.2. Konkretisht me shkresat nr.2326/2 prot datë 17.09.2021 me lëndë kthim-përgjigje formularit të ankesës nr.2326 prot datë 10.09.2021 drejtuar shoqërisë “Health&Light“ SHPK, dhe nr.2338/1 prot datë 21.09.2021 me lëndë kthim-përgjigje formularit të ankesës nr.2338 prot datë 13.09.2021 drejtuar shoqërisë, “Montal“ SHPK autoriteti kontraktor (KSHA) ka pranuar pretendimet e ankimuesve si më poshtë:

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK : në pajisjen 1 Eko Kardio Vaskulare përcaktimi i kufijve (rangut) të frekuencave nga 1.5 deri në të paktën 4 MHz favorizon një model të caktuar të një prodhuesi të vetëm që është General Electric i cili ofron zgjidhjen e tij për një sondë me frekuencë 1-4 MHz. Pse të mos kërkohet rangu i **frekuencave 1-5 MHz** i cili përveç se rrit përfitueshmërinë klinike hap dhe konkurrencën pa cënuar asnjë OE. **Ose dhe rangu 2-4 MHz** që përdoret gjërësisht në aplikime kardiake.*

*Argumentimi i AK: **Frekuenca e sondës kardiake të kërkuar 1.5 MHz nuk kufizon prodhuesin Philips i cili mund të ofrojë sondën e mëposhtme që e plotëson specifikimin e kërkuar. Modeli X5 (Frekuenca 1-5 MHz).***

***Bëhet: AK sqaron se pranon të bëjë një modifikim të këtij specifikimi teknik për të qenë sa më të qartë dhe më të kuptueshëm për OE në mënyrë që të mos vlerësohet si kriter përjashtues: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë: të përfshijë diapazonin 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz.***

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK në Pajisjen 3 Eko kardio vaskulare (transtorakale me 3 sonda), kërkesa që frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë të jetë nga 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz favorizojnë të njëjtin prodhues duke cënuar konkurrencën. Për të qenë më gjithëpërfshirës AK duhet të kërkojë 2-4 MHz dhe fushë pamje 55 ose për të ruajtur kërkesat klinike dhe trajtim të barabartë të gjithë OE të kërkojë 1-5 MHz .*

*Argumentimi i AK **Bëhet: AK sqaron se pranon të bëjë një modifikim të këtij specifikimi teknik për të qenë sa më të qartë dhe më të kuptueshëm për OE në mënyrë që të mos vlerësohet kriter përjashtues.***

***Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë: të përfshijë diapazonin 1.5 MHz deri në të paktën 4 MHz.***

***Fushpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 55 ose më shumë.***

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK për Pajisjen 4 Eko Radiologjike me sondë abdominale konvekse dhe lineare është kërkuar ndër të tjera....*



*Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit. Kjo kërkesë çënon në mënyrë flagrante konkurrencën pasi asnjë nga proshuesit e ekove në botë nuk do të mund të ofrojë një produkt në këtë nivel. Ju lutem ta modifikoni.*

***Argumentimi i AK: Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka kërkuar se si duhet ndryshuar specifikimi i mësipërm. Për këtë arsye është ulur intervali dinamik me 50 dB dhe është shtuar fjala për afërsisht për të përfshirë vlera të për afërta që mund të kenë prodhues të ndryshëm.***

***Bëhet: Interval dinamik i rregullueshëm për afërsisht 350 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.***

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në 3 KHz në varësi të modalitetit të skanimit. Edhe kjo kërkesë favorizon po të njëjtin prodhues dhe çënon konkurrencën. Kërkojmë që kjo kërkesë të modifikohet ose të hiqet pasi nuk ka asnjë relevancë klinike.*

***Argumentimi i AK. Për të siguruar një pjesmarrje sa më të madhe AK vendosi të bëjë ndryshimin e këtij specifikimi teknik duke pranuar pretendimet e OE-së.***

***Bëhet: Frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në të paktën 2 KHz në varësi të modalitetit të skanimit.***

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Sondë konvekse e përdorshme ndër të tjera për ekzaminimet shear ëave; Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 1 MHz deri në të paktën 5MHz; Fushëpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 100 gradë ose më shumë.*

*Në kërkesën më sipër kërkohet që të përdoret për ekzaminimet Shear –ëave ndërkohë që nuk specifikohet për çfarë ekzaminimesh dhe është e paqartë çfarë aplikacionesh apo modalitete skanimit operatorët duhet të ofrojnë. Ju lutem ta qartësoni.*

***Argumentimi i AK. Përshkrimi i sondës konvekse sipas specifikimit më lart përmban një lapsus në lidhje me funksionin shear-ëave i cili do të hiqet nga përshkrimi.***

***Bëhet: Sondë konvekse: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 1 MHz deri në të paktën 5MHz; Fushëpamja minimale duhet të garantohet deri në të paktën 100 gradë ose më shumë.***

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Sondë lineare. Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 2 MHz deri në të paktën 10 MHz ose 4 MHz deri në të paktën 12 MHz. Fusha minimale e skanimit 35 mm. Sqarojmë se kërkesa e sondës më sipër bie ndesh me kërkesën tjetër ku citohet: Modalitet Elastografi strain. E aplikueshme me sondë lineare. Dihet që me modalitetin elastografinë Strain kërkon minimalisht një fushë minimale skanimit prej 50 mm. Kërkojmë që ky specifikim të modifikohet si dhe rangi i frekuencave nga 4-12 MHz të bëhet 5-12 MHz për të qenë më gjithëpërfshirëse sic kërkon LPP.*

**Argumentimi i AK:** *Elastografia strain përdoret për ekzaminimin e indeve të buta dhe nuk ka ndonjë kufizim në lidhje me fushën minimale të skanimit. Fusha e skanimit prej 50mm që ju propozoni është përfshirës dhe ezaurues ndaj specifikimit të kërkuar i cili nuk ka nevojë të ndryshohet. Në lidhje me rangun e frekuencave do të kryhen ndryshimet përkatëse sipas propozimit tuaj.*

**Bëhet:** *Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë të përfshijë diapazonin 2 MHz deri në të paktën 10 MHz ose të përfshijë diapazonin 5 MHz deri në të paktën 12 MHz.*

**Fusha minimale e skanimit 35 mm.**

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK: Për pajijen 5 Eko Radiologjike e avancuar është kërkuar ndër të tjera:*

*Këndi i skanimit maksimal duhet të arrijë deri në të paktën 160 gradë në varësi të sondës së përdorur.*

*Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.*

*Frekuenca e rifreskimit të imazheve deri në 3 KHz në varësi të modalitetit të skanimit.*

- *Kërkesa që këndi i skanimit maksimal duhet të arrijë deri në të paktën 160 gradë në varësi të sondës së përdorur është jo e qartë pasi asnjë nga sondat e kërkuara për këtë specifikim nuk është kërkuar me atë kënd skanimit ndaj AK duhet të sqarohet arsyen e vendosjes së kësaj kërkesë.*

**Argumenti i AK:** *Ju sqarohet se këndi i skanimit maksimal nuk i referohet sondave por aftësisë së pajisjes për të arritur një fushpamje të caktuar.*

- *Kërkesa teknike Intervali dinamik i rregullueshëm deri në të paktën 400 dB dhe rregullim automatik i fokusimit çënon në mënyrë flagrante konkurrencën pasi asnjë nga prodhuesit e Ekove në botë nuk do mundet të ofrojë një produkt me këtë nivel ndaj kjo kërkesë duhet të modifikohet.*

**Argumentimi i AK:** *Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka kërkuar se si duhet ndryshuar specifikimi i mësipërm. Për këtë arsye është ulur intervali dinamik me 50 dB dhe është shtuar fjala “përafërsisht” për të përfshirë vlera të përafërta që mund të kenë prodhues të ndryshëm.*

**Bëhet:** *Interval dinamik i rregullueshëm përafërisht 350 dB dhe rregullim automatik i fokusimit.*

- *Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik Health &Light SHPK : Sondë lineare (aplikime vaskulare dhe muskuloskeletale)*

*Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellësisë 2 MHz deri në të paktën 10 MHz*

*Fusha minimale e skanimit 50 mm.*

*Për këtë sondë na duket rangun i kërkuar 2-10MHz përsëri qëllimisht pasi për aplikime vaskulare dhe muskuloskeletale frekuencat e përdorshme janë nga 5-12 MHz.*

*Argumentimi i AK. Në vijim të propozimit konkret nga operatori ekonomik do të përshatën frekuencat në rangun 5-12 MHz ose më gjërë.*

*Bëhet: Frekuenca e aplikueshme në varësi të thellesisë 5-12 MHz osë më gjërë.*

- Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes Montal SHPK: **Artikulli Nr.4 Eko Radiologjike me sondë abdominale konvekse dhe Lineare**

*Kerkohe: Sonde Konvekse e perdorshme nder te tjera edhe per ekzaminimet “shear-ëave”; Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz; Ne specifikimin e mesiperme eshte kerkuar qe sonda konvekse te jete e perdorshme per ekzaminime “shear-ëave” nderkohe qe ky funksion nuk kerkohe ne specifikimet teknike per kete pajisje. Gjithashtu, nuk eshte kerkuar as qe funksioni “shear-ëave” te jete opsional per permiresime ne te ardhmen. Per kete arsye, mendojme se kerkesa qe sonda konvekse te jete e perdorshme per aplikime “shear-ëave” nuk perputhet me kerkesat e aplikimit te kesaj pajisje. Ju lutemi te keni ne konsiderate faktin qe nje sonda konvekse me funksion “Shear-ëave” nuk funksionon ne nje pajisje ekografike e cila nuk e disponon kete teknologji. Prandaj, kerkojme qe kjo kerkese te hiqet.*

*Sa mesiper, per te mundesuar pjesemarrjen e kompanise tone dhe produkteve prestigjoze qe mund te ofrojme, kerkojme qe specifikimi teknik final te ndryshohet si vijon:*

***Sonde Konvekse Abdominale***

***Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz.***

***Argumentimi i AK: Përshkrimi i sondës konvekse sipas specifikimit më lart përmban një lapsus në lidhje funksionin shear-ëave i cili do të hiqet nga përshkrimi.***

*Sonde Konvekse Abdominale*

*Gjithashtu, per te garantuar nje pjesëmarrje sa me te gjere ne kete procedure prokurimi **Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: te perfshije diapazonin 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz.***

***Bëhet***

***Sonde Konvekse Abdominale***

***Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: te perfshije diapazonin 1 MHz deri ne te pakten 5 MHz***

- Lidhur me pretenimin e operatorit ekonomik Montal SHPK: *Sonde Lineare Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 4MHz deri ne te pakten 12 MHz. Ne lidhje me specifikimin e mesiperme, kerkojme qe ne diapazonin e frekuencave te perfshihet edhe frekuenca 5-11 MHz per te mundesuar ofrimin e produkteve prestigjoze te prodhuesit GE Healthcare qe kompania jone*

perfaqeson dhe per te qene ne perputhje me Nenin 36, Pika 2 -Specifikimet teknike te ligjit te prokurimit publik. Sa me siper, kerkojme qe ky specifikim te ndryshohet si vijon:

*Sonde Lineare*

*Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 5MHz deri ne te pakten 11 MHz.*

### **Vlerësimi i KSHA.**

**Bëhet:** *Frekuenca e aplikueshme ne varesi te thellesise: : te perfshije diapazonin 2 MHz deri ne te pakten 10 MHz ose 5MHz deri ne te pakten 11 MHz.*

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018,

datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Health” & “Light” SHPK, “Montal“ SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04463-09-02-2021 me objekt Loti 1 “Ekokardiography”, me fond limit 39,700,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 05-10-2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**